

Vendim nr. 86 datë 26.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 26.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (T) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: TATJANA MILO, PETRAQ MILO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3353, datë 26.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 16, pika 2, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me kontratën e shitjes të datës 05.05.2000, kërkesja Tatjana Milo ka blerë nga shtetasi E.H. një apartament të ndodhur në Tiranë, rruga “Vaso Pasha”, godina nr. 7, të përbërë nga 3

dhoma, një kuzhinë e aneks, në katin e tretë të një godine, pasuri që e ka regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë. Këtë pasuri shtetasi E.H. e ka blerë me kontratën e shitjes të datës 07.02.1998 nga shtetasi F.Sh., që rezulton të jetë pronar i godinës, shkalla qendrore e pjesës jugore të banesës që ndodhet në rrugën “Vaso Pasha”, të përbërë nga dy apartamente banimi dhe ambiente në katin përdhes që i takon asaj. Godina ka funksionuar me shkallë të brendshme rrethore, të cilat nuk ekzistojnë më, ndërkohë që hyrja për në banesë realizohet nga një palë shkallë të jashtme që të çojnë në katin e dytë nëpërmjet dhomës së shtetases L.Sh., në hollin e shkallëve të katit të dytë dhe më pas vazhdojnë shkallët e brendshme rrethore, të cilat të çojnë në katin e tretë ku ndodhet apartamenti i kërkuësve.

2. Në këtë godinë kanë në pronësinë e tyre pasuri të paluajtshme edhe shtetaset L.Sh. dhe I.Ç., trashëgimtare ligjore të shtetasit F.Sh. Më konkretisht, shtetasja L.Sh. është pronare e një apartamenti të ndodhur në katin përdhes, me dalje më vete, në rrugën “Pjetër Bogdani”, me sipërfaqe 97 m² dhe e një apartamenti të ndodhur në katin e dytë, me sipërfaqe 86 m². Po kështu, rezulton se shtetaset L.Sh. dhe I.Ç., janë bashkëpronare në ½-ën pjesë të një sipërfaqeje prej 23 m² ambient, hyrja e apartamentit të 5-të, që bën pjesë në shkallën qendrore të anës jugore të banesës, sipas vërtetimit të pronësisë. Këtë pasuri ato ia kanë shitur shtetases M.H., me kontratën e shitjes të datës 17.02.2004 dhe më vonë, në bazë të kërkesës së shtetases L.Sh., me urdhrin e datës 11.02.2004 regjistruesi ka urdhëruar të regjistrohet sipërfaqja 23 m² ambient, hyrje e apartamentit të 5-të dhe të jetë si bashkëngjitje e numrit hipotekor 5026, datë 18.02.1994.

3. Kërkuësit Tatjana Milo dhe Petraq Milo kanë paraqitur padi në gjykatë me objekt: (i) njohjen e së drejtës të përdorimit të ambienteve të përbashkëta si një bashkëpronësi e detyrueshme e godinës ku banojnë; (ii) pushimin e cenimit të posedimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen; (iii) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të datës 17.02.2004 të ambientit prej 23 m², hyrja e apartamentit 5, që bën pjesë në shkallën qendrore të anës jugore të banesës dhe fshirjen nga regjistri hipotekor të shënimeve të bëra në favor të shtetases M.H.; (iv) detyrimin e ZVRPP-së, Tiranë të ndreqë gabimet me karakter material, si dhe pasaktësitë në regjistrat hipotekorë për pasurinë e shtetaseve L.Sh. dhe I.Ç., të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 92, datë 13.02.2004, zona kadastrale 8270; (v) detyrimin e palës së paditur për të njohur dhe respektuar bashkëpronësinë e detyrueshme për këtë ambient të përbashkët; (vi) pushimin e cenimit të posedimit dhe mospërsëritjen e tij në të ardhmen; (vii) marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar ZVRPP-në, Tiranë për të mos kryer veprime me pasurinë nr. N-B/226+1-5, zona

kadastrale 8270, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 159, në pronësi të shtetases M.H. Si të paditur janë thirrur shtetasit L.Sh., I.Ç., M.H. dhe ZVRPP-ja, Tiranë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3868, datë 29.04.2008, ka vendosur: *“Rrëzimin e padisë si të pambështetur në prova e në ligj.”*. Sipas gjykatës, pala paditëse nuk ka provuar ekzistencën e bashkëpronësisë për ambientet që ajo pretendon “hyrje në godinë, hollet dhe shkallët e kësaj godine”. Pronari F.Sh. nuk i ka shitur ose parashikuar ndryshe blerësit E.H. për truallin, shkallët, hollet, themelet dhe ambientet e tjera, për të cilat ai është pronari i vetëm i godinës. Në këto kushte, kur E.H. nuk ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë mbi këto ambiente, as paditësit Tatjana e Petraq Milo nuk mund të pretendojnë një bashkëpronësi të detyrueshme të këtyre ambienteve, konkretisht të shkallëve e brendshme, hyrjes në godinën ku ata banojnë. Në vlerësimin e gjykatës, e drejta e palës paditëse ka qenë posedimi i ligjshëm i atyre shkallëve, ashtu sikundër vetë e kanë kërkuar në pikën e dytë të objektit të padisë, kërkim për të cilin ajo ka arritur në përfundimin se padia është parashikuar. Në lidhje me kërkimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes të datës 17.02.2004 gjykata e ka vlerësuar të pambështetur në prova e në ligj, pasi pala paditëse nuk ka provuar në gjykim se është bashkëpronare në ambientin hyrje në apartamentin e 5-të, që bën pjesë në shkallën qendrore të anës jugore të banesës. Kundër këtij vendimi kërkuar kanë paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 705, datë 26.05.2009 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3868, datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, se ajo ka arritur në përfundime të drejta e bindëse, të cilat bazohen në dispozitat ligjore procedurale e materiale, si dhe në provat e marra gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Kundër këtij vendimi kërkuar kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-135, datë 08.03.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse (kërkuar) Tatjana Milo dhe Petraq Milo.

7. Në datën 22.05.2014, bazuar në nenin 494, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), kërkuar i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 3868, datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 705, datë 26.05.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas tyre, në datën 10.04.2014, me vendim të INUK-ut, Dega e Tiranës, janë prishur përfundimisht shkallët e jashtme, të cilat ishin prishur pjesërisht me

vendimin e Policisë Ndërtimore, moment pas të cilit kërkuesit janë përballur me mbylljen e dyerve të hyrjes në kafazin e shkallëve të brendshme dhe moslejimin që të futen në apartamentin e tyre, me pretendimin se sheshpushimi i shkallëve, me sipërfaqe 23 m², i është shitur shtetases M.H., pasuri e regjistruar edhe në ZVRPP. Ata kanë pretenduar se janë vënë në dijeni të provave të reja me shkresë, të panjohura më parë prej tyre, me rëndësi për çështjen, e konkretisht: (i) dokumentet origjinale teknike të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit që bëjnë fjalë për ndërtimin e bërë nga E.B., prej nga rezulton se sipërfaqja prej 23 m² është ambient i kafazit të shkallëve, e vetmja hapësirë që lejon hyrjen në banesë për të gjithë banorët e godinës ku banojnë kërkuesit; (ii) shkresën nr. 3966/1, datë 24.04.2014 të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), sipas së cilës regjistrimi që i është bërë sipërfaqes prej 23 m² është i parregullt; (iii) certifikatën e pronësisë të datës 19.05.2014 për apartamentin e tyre të banimit, ku në përshkrimin e veçantë thuhet shprehimisht: *“Sipërfaqet e përbashkëta janë 23 m² kati I. Katet e tjera me sipërfaqe 11-12 m² sipërfaqe të përbashkëta.”*.

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3353, datë 26.10.2022, bazuar në nenet 494 dhe 498 të KPC-së, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuesve.

9. Në vendimin e tij, fillimisht, Kolegji Civil ka shprehur vlerësimin në lidhje me procedurën e gjyqimit në Gjykatën e Lartë të kërkesës për rishikim të kërkuesve, marrë shkas nga ndryshimet që ka pësuar KPC-ja deri në momentin e shqyrtimit të saj. Pas një analize ligjore, Kolegji Civil ka konkluduar se: (i) për aspekte procedurale që lidhen me organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe të pushtetit gjyqësor, që i përkasin rendit publik dhe nuk cenojnë interesa dhe të drejta procedurale ngushtësisht private të palëve ndërgjyqëse, do të gjejë zbatim ligji procedural në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes; (ii) në aspektin e parimit të sigurisë juridike dhe të pritshmërisë legjitime, për aspekte procedurale që lidhen me të drejta kushtetuese dhe ligjore, subjektive të palëve në proces, sikurse është e drejta e ankimit, për përmbajtjen ose kushtet e ushtrimit të tij, do të zbatohet ligji procedural i kohës kur ka lindur kjo e drejtë, pra, e thënë ndryshe, në lidhje me shkaqet ose anën formale të pranueshmërisë së kërkesës për rishikim të ushtruar përpara datës 05.11.2017, do të zbatohet ligji i kohës së paraqitjes së kërkesës (*shih paragrafët 26.1 dhe 26.2 të vendimit të Kolegjit Civil*). Mbështetur në këto përfundime, Kolegji Civil ka vlerësuar se shqyrtimi i kërkesës për rishikim të kërkuesve do të bëhet nga Gjykata e Lartë referuar rregullimit ligjor tranzitor të bërë në nenin 109 të ligjit nr. 38/2017, sipas të cilit ky

shqyrtim, qoftë në dhomën e këshillimit ose në seancë gjyqësore, do të bëhej sipas përcaktimeve të ligjit aktual në fuqi, pra nga një trup gjykues i formuar nga tre gjyqtarë.

10. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës për rishikim, Kolegji Civil fillimisht ka evidentuar se sipas nenit 494, shkronja “a”, të KPC-së duhet të plotësohen katër kushte kumulative për t’i dhënë udhë rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë: (i) dalja e rrethanave ose provave të reja; (ii) këto rrethana ose prova të reja nuk dihen dhe as nuk mund të dihen nga pala apo gjykata gjatë gjykimit; (iii) këto prova të mos jenë administruar gjatë gjykimit; (iv) të kenë rëndësi esenciale për zgjidhjen e çështjes. Ndërkohë, kushti i dytë nënkupton se prova ose rrethana e re jo vetëm nuk dihet nga pala gjatë gjykimit, por edhe nuk ekzistonte mundësia objektive e dijenisë mbi të, ndërkohë që mungesa e dijenisë lidhet me pamundësinë objektive dhe jo subjektive të palëve për të gjetur provat me të cilat do të provojnë pretendimet e saj gjatë gjykimit. Mbështetur në këto përcaktime, Kolegji Civil ka arritur në konkluzionin se kërkesa për rishikim nuk mund të shërbente si mjet për rihapjen e procesit gjyqësor, sa herë që pala ndërgjyqëse, e cila kishte ometuar për faj të saj në përmbushjen e barrës së provës gjatë gjykimit, gjen prova që objektivisht mund dhe duhet t’i kishte paraqitur gjatë procesit gjyqësor (*shih paragrafët 38 dhe 39 të vendimit të Kolegjit Civil*).

11. Më tej, për sa i përket kërkesës për rishikim të kërkuësve, Kolegji Civil ka arritur në përfundimin se ajo nuk gjen mbështetje në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 494 të KPC-së, duke arsyetuar se shkaqet për të cilat është pretenduar rishikimi i vendimit të formës së prerë, nuk janë shkaqe me të cilat mund të përdoret mjeti i jashtëzakonshëm për kundërshtimin e vendimeve, sikurse është kërkesa për rishikimin e vendimeve të formës së prerë. Prova e paraqitur si “e re” nga kërkuësi, shkresa e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit, së bashku me dokumentacionin teknik, nuk plotësojnë kriteret për të mundësuar rishikimin e vendimit të formës së prerë, pasi kërkuësi nuk kanë argumentuar se përse gjatë gjykimit të çështjes në themel kanë qenë në pamundësi për të paraqitur informacion nga ky institucion dhe se nuk vërtetohej lidhja ose rëndësia e kësaj prove për çështjen e themelit që kërkohet të rishikohet. Po ashtu nuk argumentohet dhe nuk provohet rëndësia që kanë për çështjen shkresa e ZQRPP-së dhe certifikata e pronësisë e datës 19.05.2014, dokumente këto që nuk mund të vlerësohen se kanë rëndësi për thelbin e mosmarrëveshjes të zgjidhur me vendimin gjyqësor të formës së prerë, që buronte nga e drejta subjektive e pronësisë për sipërfaqen 23 m², për të cilën kërkuësi nuk kanë paraqitur ndonjë “provë të re shkruese”, si akti për krijimin e së drejtës, me të dhëna të ndryshme, në të kundërt të

konkluzionit të pranuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për më tepër, këto dy dokumente nuk kanë ekzistuar përpara përfundimit të shqyrtimit të çështjes me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe të jenë zbuluar pas këtij momenti nga kërkuesit për shkak të pamundësisë objektive për t'i siguruar më parë, por përmbajnë të dhëna për veprime administrative të kryera pas marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor për të cilin kërkohet rishikimi (*shih paragrafët 40 dhe 42 të vendimit të Kolegjit Civil*).

12. Në datën 25.02.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3353, datë 26.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kjo kërkesë, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000 me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 10.03.2023.

II

Pretendimet e kërkuesve

13. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar u ka cenuar:

- 13.1. *Të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke mos i njoftuar kërkuesit për datën e seancës gjyqësore, ndërkohë që në kërkesën për rishikim janë ngritur çështje që duhej të ishin diskutuar në prani të kërkuesve. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomën e këshillimit, pa iu dhënë mundësinë kërkuesve të dëgjoheshin në seancë gjyqësore.
- 13.2. *Të drejtën e aksesit*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë u ka mohuar përfundimisht kërkuesve të drejtën për të kundërshtuar vendimin nr. 3868, datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin. Nëpërmjet këtij të fundit kërkuesit nuk mund të hyjnë në apartamentin e tyre që ndodhet në katin e tretë të godinës, pasi iu pengohet hyrja në ndërtesë nga pala e paditur, e cila pretendon se është pronare e vetme e godinës.
- 13.3. *Të drejtën e pronës private*, pasi kërkuesit nuk mund të sillen si pronarë të apartamentit të tyre, për shkak se nuk lejohen të përdorin hyrjen e godinës. Pala e paditur në proces u kërkon atyre pagimin e një takse për të kaluar në hyrjen e

ndërtesës, për shkak të një vendimi civil të formës së prerë, që në kundërshtim të hapur me dispozitat e Kodit Civil, e ka konsideruar hyrjen e ndërtesës në pronësi ekskluzive të një banori të vetëm. Ndërkohë që provat e reja të paraqitura në kërkesën për rishikim vërtetojnë se ambienti i zotëruar nga pala e paditur është e vetmja hapësirë që lejon hyrjen në banesë për të gjithë banorët e godinës ku banojnë kërkuessit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessve

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

15. Kërkuessit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e

shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në jurisprudencën kushtetuese është pranuar se vlerësimi i respektimit të standardeve kushtetuese gjatë këtij procesi i nënshtrohet juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 61, datë 27.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, edhe ky kriter konsiderohet i plotësuar në rastin konkret.

17. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi i janë drejtuar Gjykatës në datën 25.02.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, mban datën 26.10.2022. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimet e ngritura nga kërkuesi *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj do të shqyrtohen në vijim. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë u ka mohuar përfundimisht të drejtën për të kundërshtuar vendimin nr. 3868, datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është marrë në kundërshtim me ligjin. Ata kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës private, pasi nuk mund të sillen si pronarë të apartamentit të tyre, duke qenë se nuk lejohen të përdorin hyrjen e godinës, për shkak të vendimit gjyqësor që e ka vlerësuar hyrjen e ndërtesës në pronësi ekskluzive të një banori të vetëm. Sipas kërkuesve, provat e reja të paraqitura në kërkesën për rishikim vërtetojnë që ambienti i zotëruar nga pala e paditur është e vetmja hapësirë që lejon hyrjen në banesë për të gjithë banorët e godinës ku banojnë kërkuesit. Për rrjedhojë, këto pretendime do të analizohen në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u njoftuar dhe asaj për t’u dëgjuar

19. Kërkuesit pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim duke mos i njoftuar ata për datën e seancës dhe se e ka marrë në shqyrtim çështjen në dhomën e këshillimit, pa iu dhënë mundësinë të dëgjoheshin në seancë gjyqësore.

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata konstaton se ligji procedural civil përcakton se shqyrtimi i kërkesës për rishikim bëhet sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi, në rastin konkret sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në Gjykatën e Lartë në Titullin II, Pjesa e Tretë, të KPC-së. Referuar këtyre të fundit, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit (neni 482, pika 1, i KPC-së). Për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit në Gjykatën e Lartë ligji procedural civil përcakton se sekretaria e saj njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjyimit të paktën 15 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa (neni 482, pika 3, i KPC-së).

22. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me ankimin e jashtëzakonshëm të kërkuësve, pra me kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Referuar të dhënave të publikuara në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura për gjykim në dhomë këshillimi”, konstatohet se në datën 11.10.2022, pra 15 ditë para shqyrtimit të kërkesës në dhomën e këshillimit, ajo gjykatë ka bërë shpalljen e listës së çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 26.10.2022, ku përfshihet edhe çështja e kërkuësve, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Gjithashtu, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, nuk rezulton, dhe as nuk është pretenduar nga kërkuësit, që ata vetë ose përfaqësuesi i tyre të kenë paraqitur të dhënat e postës elektronike në kërkesën për rishikim, për qëllim të njoftimit edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 482, pika 3, të KPC-së ose pikës 5 të urdhrin nr.

131, datë 02.07.2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”. Në këtë kuptim, konstatohet se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale që rregullojnë njoftimin e palëve në atë gjykatë. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, kërkuessit nuk kanë arritur ta ngrenë atë në nivel kushtetues, për sa kohë që gjykimi i kundërshtuar është vënë në lëvizje mbi bazën e kërkesës së tyre dhe është në lidhje me këto shkaqe dhe prova që Gjykata e Lartë ka vlerësuar plotësimin e kriterëve ligjore në kuptim të nenit 494, shkronja “a”, të KPC-së (kushtet e pranueshmërisë së kërkesës).

23. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuessve për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

24. Kërkuessit pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë u ka mohuar përfundimisht të drejtën për të kundërshtuar vendimin nr. 3868, datë 29.04.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është marrë në kundërshtim me ligjin, duke e konsideruar hyrjen e ndërtesës në pronësi ekskluzive të një banori të vetëm. Nëpërmjet këtij vendimi ata janë cenuar në pronën e tyre, pasi nuk mund të sillen si pronarë të apartamentit, për shkak se nuk lejohen të përdorin hyrjen e godinës. Sipas kërkuessve, provat e reja të paraqitura në kërkesën për rishikim vërtetojnë që ambienti i zotëruar nga pala e paditur është e vetmja hapësirë që lejon hyrjen në banesë për të gjithë banorët e godinës ku ata banojnë.

25. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë

është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (shih vendimet nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Gjykata ka theksuar se rishikimi përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (shih vendimet nr. 11, datë 10.03.2023; nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 74, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Kolegji vëren se krahas përcaktimit në mënyrë të shprehur të rasteve të rishikimit, ligji përcakton po ashtu edhe kushtet e pranueshmërisë së kërkesës për rishikim. Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata ka theksuar se mospranimi i kërkesës për rishikim i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme që të jepet një vendim i arsyetuar për shkaqet që e kanë çuar gjykatën në marrjen e një vendimi të tillë (shih vendimin nr. 61, datë 27.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se për sa i përket shqyrtimit paraprak mbi rëndësinë e provës së re, ai është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon kjo Gjykatë (shih vendimet nr. 7, datë 07.03.2011; nr. 4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

29. Në këtë kuptim pretendimet e kërkuësve kanë të bëjnë, në thelb, me natyrën e provave të paraqitura bashkëlidhur kërkesës për rishikim, pretendime këto me natyrë ligjore, që nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për më tepër, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të kërkuësve, duke arsyetuar në vendimin e saj se përse provat e paraqitura nuk plotësojnë kriteret që lejojnë rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kuptim të neneve 494 dhe 495 të KPC-së.

30. Për sa më sipër, edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.